



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 26 nëntor 2025

VLERËSIM

Lënda: **Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregullator (RIA) për projektligjin “Për Shoqëritë Evropiane të Bashkëpunimit”.**

Vlerësimi i përgjithshëm: 87/100

Përgjithësisht pozitiv



A) Informacione të përgjithshme mbi procesin

Emërtimi i propozimit të politikës

Projektligji “Për Shoqëritë Evropiane të Bashkëpunimit”

Ministria udhëheqëse	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
Numri/data e RIAs	2025 – MEI – Nr.8
Statusi	Finale
Data e marrjes për shqyrtim	11 gusht 2025
Data e komenteve të fundit	20 nëntor 2025
Numri i komenteve të kryera/të reflektuara	20/21
Numri i ripunimeve	3

A) Konteksti i politikës

Qëllimi i kësaj nisme është krijimi i kuadrit ligjor të posaçëm për themelimin dhe funksionimin e Shoqërisë Evropiane të Bashkëpunimit (SHEB) në Republikën e Shqipërisë, në përputhje të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Me këtë nismë synohet transpozimi i Rregullores (KE) 1435/2003 të Këshillit Evropian të 22 korrikut 2003 “Për Statutin e Shoqërisë Evropiane të Bashkëpunimit”.

B) Vlerësimi i përgjithshëm

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Për arsyet e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë mjaftueshmërisht cilësore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar

C) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë *plotësisht* në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të thellohet më tej analiza ekonomike sasiore ekonomike (kosto/përfitimi), për të gjitha grupet e prekura.
2. Te redaktohet nga ana gramatikore raporti për të përmirësuar qartësinë e tij.